

KATEGORIA E SHKALLËS TE MBIEMRAT NË GJUHËN ANGLEZE DHE SHQIPE (ANALIZË KONTRASTIVE)



Gjuhësi

Fjalët kyçe: mbiemër, shkalla e lartë, shkalla e njejtë, shkalla e ulët, analizë, gjuhë angleze, gjuhë shqipe.

Remzije Nuhiu

Fakulteti Filologjik. Programi Studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze.
Universiteti Shtetëror i Tetovës.

Abstract

Gramatika është një fushë e ndërlikuar shkencore dhe fakti se të gjitha gjuhët kanë rregulla të ndryshme, këtë fushë e bën edhe më të ndërlikuar. Si rrjedhojë e kësaj paraqitet nevoja që të bëhet analizë kontrastive ndërmjet gjuhëve me qëllim që të eliminohen të gjitha paqartësitë rreth një problemi të shtruar ose një hulumtimi përkatës. Ky punim ka për qëllim studimin e kategorisë së mbiemrit në mes gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe. Në këtë punim do të elaborohen disa shembuj që nëpërmjet një analize kontrastive do të na çojnë deri te një perfundim mbi dallimet dhe ngjajshmëritë e kategorisë së shkallës së mbiemrave në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe. Ky punim do të bazohet në romanin *The Great Gatsby* nga autori amerikan Frensis Skot Fitxherald dhe përkthimi i të njejtit nga përkthyesi Stavri Pone. Ky punim do të tentojë ta thellojë teoritikisht dhe praktikisht në këtë rast kategorinë e shkallës së mbiemrave në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe. Gjithashtu ky hulumtim do të jetë në të mirë të studentëve që ta kenë më lehtë kuptimin mbi kategoritë e shkallës së mbiemrave gjatë përdorimit të tyre.

1. Hyrje

Gjuha është mekanizmi kryesor i cili e bën të mundur komunikimin e ndërsjellë të botës njerëzore. Çdo njeri ka gjuhën dhe kulturën e vet e cila e dallon nga gjuhët dhe komunitetet tjera. Rreth 6.500 gjuhë fliten nëpër botë ku secila nga këto gjuhë i ka rregullat e saja gramatikore dhe nevoja për humumtime ndërgjuhësore nuk ka fund. Shumë gjuhëtarë këto rregulla dhe fenomene gjuhësore i studjojnë dhe bëjnë analizë kontrastive të tyre në aspekte të ndryshme gjuhësore si gramatikore, kulturore, etnologjike, letrare, etj. Një analizë kontrastive gramatikore do të ishte në fushat e ndryshme të gramatikës, edhe atë: fonologjike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore. Në këtë humumtim do të ndalemi në fushën morfologjike edhe atë në kategorinë e shkallës së mbiemrit. Gramatika është një fushë e ndërlikuar shkencore dhe fakti se të gjitha gjuhët kanë rregulla të ndryshme, këtë fushë e bën edhe më të ndërlikuar. Si rrjedhojë e kësaj paraqitet nevoja që të bëhet analizë kontrastive ndërmjet gjuhëve me qëllim që të eliminohen të gjitha paqartësitë rreth një problemi të shtruar ose një hulumtimi përkatës. Mirëpo për të kluar tek shkalla e mbiemrit ne duhet të njihemi pak me fuhsën e morfologjisë. Fusha e gramatikës e cila ka të bëjë me strukturën e fjalëve dhe me marrëdhëniet ndërmjet fjalëve duke i përfshirë morfemat që përbëjnë ato, teknikisht quhet morfologji, rrjedh nga fjala greke morphe 'formë, dhe morfemat që mund të kuptohen si njësi minimale të morfologjisë, kështu e definojnë morfologjinë, Karsteirs MekKarthi (Carstairs-McCarthy, 2002:16). Nga ana tjetër, sipas Liber (Lieber, 2009:2) -Morfologjia është studimi i formimit të fjalës, duke përfshirë mënyrat se si fjalët e reja shpiken në të gjitha gjuhët e botës, dhe mënyrat se si format e fjalëve janë të ndryshme në varësi se si ato përdoren në fjali.

Në këtë punim do të elaborohen disa shembuj të cilat do të na çojnë deri te një perfundim mbi dallimet dhe ngjajshmëritë e kategorisë së shkallës së mbiemrave në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe. Ky punim do të bazohet në romanin *The Great Gatsby* nga autori amerikan Frensis Skot Fitxherald dhe përkthimi i të njejtit nga përkthyesi Stavri Pone. Ky punim do të tentojë ta thellojë teoritikisht dhe praktikisht në këtë rast kategorinë e shkallës së mbiemrave në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe. Gjithashtu ky hulumtim do të jetë në të mirë të studentëve që ta kenë më lehtë kuptimin mbi kategoritë e shkallës së mbiemrave.

2. Problemi i Hulumtimit

Mbiemrat që prezantojnë karaktërsitikat e shkallës në gjuhën angleze njihen si *gradable* dhe kemi mbiemra që nuk mund të shënojnë shkallë të krahasores dhe sipërores dhe quhen *non-gradable*, sipas (Biber et al, 1999). Për më tepër ky punim ka të bëjë me mbiemrat *gradable*, dhe më saktësisht kategorinë e shkallës së

mbiemrave edhe ate në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe. Ky punim do të tentojë të nxjerr në pah dallimet dhe ngjajshmëritë që ka shkalla krahasore e mbiemrave në të dy gjuhët e lartpërmendura. Për bazë hulumtimi do të merret romani *The Great Gatsby* nga autori amerikan Frensis Skot Fitxherald dhe përkthimi i të njejtit nga përkthuesi Stavri Pone.

Krahasimi i mbiemrave ne gjuhën angleze

Në gjuhën angleze mbiemrat që mund të krahasohen janë të mundshme në disa relacione krahasimi që sipas (Quirk et al, 2008), ata i klasifikon sim ë poshtë:

- a) Të shkallës së lartë- krahasimi i këtyre mbiemrave bëhet me ndihmën e prapashtesave edhe ate *-er* dhe *-est* si dhe ekuivalentet e tyre me *more* dhe *most* nëse mbiemri ka dy e me shumë rrokje (*more/most beautiful*).
P.sh. Jeta is *smaller / more beautiful* than Susan
Jeta is the *smallest / most beautiful* student in the class.
- b) Të së njejtës shkallë- krahasimi në relacion me të njejtën shkallë bëhet me *as* (ose ndonjëher *so*) ...*as*.
P. sh. Fisnik is *as tall as* Bill
Fisnik is not *as / so tall as* John.
- c) Të shkallës së ulët- krahasimi në relacion me shkallën e ulët bëhet me *less* dhe *least*.
P.sh. This problem is *less difficult* than the previous on.
This is the *least difficult* problem of all.

Krahasimi i mbiemrave ne gjuhen angleze

Në gjuhën shqipe njihen tri shkallë të mbiemrit (Beci, 2005) edhe ate: shkalla pohore, shkalla krahasore dhe shkalla sipërore.

Shkalla pohore emërton tiparin e sendit mirëpo jashtë çdo krahasimi si për shembull: *vajzë e bukur*.

Shkalla krahasore tregon cilësinë e një qenieje të një sendi duke e krahasuar me cilësinë e një qenieje ose sendi tjetër. Sipas (Demiraj, Sh 2002) shkalla krahasore ka të bëjë me:

- a) Me të njejtën cilësi, vështruar te dy a më shumë sende: *Gjini është më i gjatë dhe më i bukur se ti*.
- b) Me të njejtën cilësi, vështruar tek i njejtë send , por në kohë e kushte të ndryshme si për shembull: *Tani dhoma Mimosës i duket më e pasur dhe më e bukur se herët e tjera*.
- c) Me të njejtën cilësi, vështruar te mbarë klasa ku sendi a sendet bëjnë pjesë: *Gëzimin e çmojnë dhe e mbrojnë të gjithë si një ndër djemtë më të zgjuar e më të dashur të fshatit tonë*.
- d) Me një e disa cilësi të të njejtit send (ose të disa sendeve) vështruar në përjasje me njëra tjetrën si për shembull: *Me Besimin djaloshin e lidhte një histori sa e ndërlikuar aq edhe e papëlqyer*.

Pra, mbiemri ka shkallë krahasore të barazisë (p.sh. *Ai me dëgjonte me vëmendje sikur të isha po aq e pjekur dhe e rrahur në jetë sa ai*) dhe të pabarazisë dhe kjo e fundit ndahet në: shkallë krahasore të sipërisë relative (p.sh. *Doktori ishte më i verdhë se ne të dy*), të sipërisë absolute, (*Ai duhet të ishte ndeshur me rrugët më të vështira të jetës*) dhe të ultësisë (*Pse nuk bën si ai shoku yt, që nuk ishte më pak i zgjuar nga ti?*)

Shkalla sipërore e mbiemrit tregon se cilësia e dhënë është në një shkallë shumë të lartë dhe kundrohet jashtë çdo krahasimi.(p.sh.*midis reve dukej një copë qielli shumë e kaltër*).

Pjesa Analitike

3. Dallimet Ddhe Ngjajshmërite e Kategorisë së Shkallës së Mbiemrave në Gjuhën Angleze dhe Shqipe

Në gjuhën angleze mbiemrat që mund të krahasohen janë të mundshme në disa relacione krahasimi edhe ate:

- a) *shkallës së lartë* (krahasore dhe sipërore),
- b) *shkallës së njejtë* dhe
- c) *shkallës së ulët*

ndërsa në gjuhën shqipe mbiemrat kanë tri shkallë edhe ate:

- a) **shkalla pohore**,
- b) **shkalla krahasore** (e cila ndahet në shkallë të *barazisë* dhe të *pabarazisë* dhe kjo e fundit ndahet në shkalla krahasore e sipërisë relative, shkalla krahasore e sipërisë absolute dhe shkalla e ultësisë), dhe
- c) **shkalla sipërore**.

Analiza në vazhdim e mbiemrave do të bazohet në rregullat e mbiemrave në gjuhën angleze dhe ekivalentet e tyre në gjuhën shqipe duke u bazuar në shembujt nga romani i lartëpërmendur.

Mbiemrat e Shkallës së Lartë në Gjuhën Angleze

Mbiemrat e shkallës së lartë në gjuhën angleze - krahasimi i këtyre mbiemrave bëhet me ndihmën e prapashtesave *-er* dhe *more*, në krahasore si dhe *-est* dhe *most* në sipërore. Në gjuhën angleze mbiemrat në vazhdim janë paraqitur si mbiemra të shkallës së lartë, mirëpo gjatë përkthimit të tyre në gjuhën shqipe jo të gjithë këto mbiemra ruajnë cilësinë e njejtë.

Duke u bazuar në shembujt 1,2,3,4,5,6,7, ketu të gjithë mbiemrat në gjuhën angleze të gjetur në romain e lartëpërmendur i takojnë shkallës së lartë edhe ate krahasore dhe sipërore.

Në vazhdim mbiemrat *younger* dhe *more vulnerable* në gjuhën angleze janë paraqitur në shkallën krahasore. Këto mbiemra gjatë përkthimit në gjuhën shqipe (1a), mbiemri i parë (*younger*), është paraqitur në shkallën pohore (vitet e para) ndërsa mbiemri i dytë (*more vulnerable*) ka humbur krejtësisht kategorinë e shkallës (kur isha ende aguridhe).

1.eng...*younger* and *more vulnerable* years... (p. 4)

1.alba ...Në vitet e para të rinisë sime, kur isha ende aguridhe... (fq. 5)

Shembujt në vazhdim në gjuhën angleze paraqiten në shkallën e lartë edhe ate në sipërore (*the strongest* - 2, *the most powerful* -3, *the longest* -5, *the most superficial* -6), ndërsa në gjuhën shqipe të dy shembujt e dhënë kalojnë në shkallën e pabarazisë përkthësisht në shkallën krahasore të sipërisë absolute (më të çuditshme të Amerikës -2), (më të fuqishëm të futbollit -3), (ditën më të gjatë të vitit -5) dhe (ky etiketim është më i përcipti për të shprehur-6).

2.eng...*the strongest* communities... (p. 6)

2alb...në një nga lagjet më të çuditshme të Amerikës... (fq. 10)

3.eng...*the most powerful* ends... (p. 7)

3alb ... si një nga lojtarët më të fuqishëm të futbollit... (fq. 12)

4.eng... <i>the younger of</i> the two... (p. 9)	4.alb...vajzën me moshë <u>më të re</u> ... (fq. 15)
5.eng... <i>the longest</i> day... (p. 12)	5.alb...ditën <u>më të gjatë</u> të vitit... (fq. 19)
6.eng... <i>a most superficial</i> tag... p. 7	6.alb...ndonëse ky etiketim është <u>më i përcipti</u> për të shprehur... (fq. 10)

Sa u përket shembujve në vazhdim në gjuhën angleze janë paraqitur në shkallën e lartë në krahasore dhe sipërore mirëpo, gjatë përkthimit në gjuhën shqipe mbiemri ka rrënë në shkallën krahasore të sipërisë relative. Gjymtyra e dytë e krahasimit mund të përfshij në vetvete një numër të pacaktuar sendesh, megjithate nuk mund të përfshij tërë klasën apo grupin e synuar ku bën pjesë gjymtyra e parë e krahasimit (më i fortë e me burrë sesa ti)

7.eng...I'm <i>stronger</i> and <i>more</i> of a man than you are... (p. 8)	7.alb...ngaqë jam <u>më i fortë</u> e <u>më burrë</u> sesa ti... (fq. 14)
--	--

Mbiemrat e Shkallës Së Njëjtë në Gjuhën Angleze

Mbiemrat e shkallës së njëjtë në gjuhën angleze - krahasimi në relacion me të njëjtën shkallë bëhet me ndihmën e ndajfoljes *as...as* dhe ndonjëher *so...as*. Në gjuhën angleze mbiemrat në vazhdim janë paraqitur si mbiemra të shkallës së njëjtë, mirëpo gjatë përkthimit të tyre në gjuhën shqipe jo të gjithë këto mbiemra ruajnë cilësinë e njëjtë. Duke u bazuar në shembujt 8, 9, dhe 10, këtu mbiemrat në gjuhën angleze i takojnë shkallës së njëjtë, mirëpo gjatë përkthimit në gjuhën shqipe jo gjithnjë paraqiten në shkallën krahasore të barazisë që le të kuptohet se ndonjëherë paraqiten në forma të ndryshme si dhe të humbin kategorinë e shkallës. Shembujt 8 dhe 10 në gjuhën shqipe paraqiten në shkallën krahasore të barazisë pasi që gjymtyra e dytë e krahasimit lidhet me lidhësen *sa* dhe *si* ndërsa shembulli 9 gjatë përkthimit në gjuhën shqipe e ka humbur kategorinë e shkallës. Në përgjithësi mendohet se përkthyesi nuk ka mundur që të gjej fjalinë e duhur për ta përshtatur kështu që është dashur që ta adaptoj të njëjtën.

8.eng...the grass on his lawn had grown <i>as long as</i> mine... (p. 137)	8.alb...bari i lëndinës së tij ishte rritur <u>sa</u> bari i lëndinës sime... (fq. 225)
9.eng...I've been lying on that sofa for <i>as long as</i> I can remember... (p. 11)	9.alb...Zura rrënjë në këtë divan... (fq.18)
10.eng... <i>as lovely</i> as June... (p. 59)	10.alb...e bukur <u>si</u> një degë e lulëzuar prilli... (fq.97)

Mbiemrat e Shkallës së ulët në Gjuhën Angleze

Mbiemrat e shkallës së ulët në gjuhën angleze- krahasimi në relacion më shkallën e ulët bëhet me *less* dhe *least*. Në gjuhën angleze mbiemrat në vazhdim janë paraqitur si mbiemra të shkallës së ulët (*less fashionable* 11, *less than an hour old* 12, *less surprising* 13 dhe *less charming* 14). Në gjuhën shqipe këto mbiemra janë paraqitur në shkallën e ultësisë (më pak i modës 11, më pak i habitshëm 13) dhe (më shumë se një orë që kishte lindur 12) këtu ndajfolja që i paraprinë mbiemrit përforcohet me ndajfoljen e sasisë *shumë*. Ndërsa shembulli 14 nuk kategorizohet me të njëjtën shkallë pasi që përkthyesi është dashur që ta adaptoj përkthimin në mënyre që mos i humbet kuptimi fjalisë apo mesazhit që autori ka dashur që ta përcjellë.

11.eng... <i>the less fashionable</i> ... (p. 7)	11.alb... <u>më pak i modës</u> sesa zona tjetër... (fq.10)
12.eng...she was <i>less</i> than <i>an hour</i> old... (p. 16)	12.alb...vajza s'kishte më shumë <u>se një orë që kishte lindur</u> ... (fq. 26)

13.eng...*less surprising*

than that he ... (p. 18)

14.eng...*less charming*...p.1013.alb... ishte më pak i habitshëm

sesa... (fq.30)

14.alb... një kritikë e kotë... (fq. 10)

4. Përfundimi

Duke aplikuar dhe analizuar kategorinë e shkallës së mbiemrave në gjuhën shqipe edhe ate bazuar në terminologjinë e Beci. B (2000, 2005) dhe Demiraj Sh. (2002), dhe në gjuhën angleze bazuar në terminologjinë e Quirk.R, Greenbaum.S., Leech. G., Svartvik. J., (2008), është arritur në përfundimin se gjatë përkthimit të kategorisë së shkallës së mbiemrave nga gjuha angleze në gjuhën shqipe të kategorizohen në tri vështrime edhe ate mbiemri:

1. Mund ta mbajë të nejtën kategori të shkallës gjatë përkthimit në gjuhën shqipe,
2. Mund të kalojë në ndonjë kategori të shkallës tjetër gjatë përkthimit në gjuhën shqipe, dhe
3. Mund ta humb kategorinë e shkallës gjatë përkthimit me qëllim që të rruhet kuptimi kryesor i parë.

Gjatë këtij punimi janë arritur të paktën rezultate preliminare më qëllim që të shihet më tej nëse do të duhet që të punohet rreth kësaj çështje.

References

1. Beci, B. (2000). Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë. Shkodër: Camaj-Pipa
2. Beci B. (2005). Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë: Logos-A
3. Bloomfield, L. (1933) Language, New York: Holt.
4. Bryson, B. (1990) The mother tongue: English and how it got that way, New York: Perennial publishing house.
5. Biber, D., Johansson, S., Leech, Geoffrey, Conrad, S., Finegan, E., Quirk, R., (1999) Longman Grammar of Spoken and written English, England: Pearson Education Limited.
6. Carnie, A. (2011) Modern Syntax, New York: Cambridge University Press.
7. Carstairs-McCarthy, A. (2002) An Introduction to English Morphology: Words and Their Structure, Edinburgh: Edinburgh University Press.
8. Demiraj. Sh. (2002). Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia, Tiranë: ASHRSH: Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë
9. Eastwood, J. (1994) Oxford Guide to English Grammar, Oxford: Oxford University Press.
10. Fitzgerald, F. S. (1925). The Great Gatsby. New York: Charles Scribener's Sons
11. Fitzgerald, F. S. (2012). (Pone, S. Perkth.). Getsbi i madh. Tirana: Botime Shqiptare
12. Huddleston,R., Pullum, K. G., (2002) The Cambridge Grammar of the English Language, Cambridge: Cambridge University Press.
13. Lieber, R. (2009) Introducing Morphology, Cambridge: Cambridge University Press.
14. Likaj, E. Ç. (2010) Morfologji e shqipes standard, Tiranë
15. Quirk.R, Greenbaum.S., Leech. G., Svartvik. J., (2008). A Comprehensive Grammar of the English Language, England: Longman Group Limited
16. Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G., Svartvik, J. (1985) A Comprehensive Grammar of the English Language, England: Pearson Education Limited.
17. Sheperi I. D., (1927) Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe, Vlorë.
18. Sosyr F. (1977) Kurs i gjuhësisë së përgjithshme, Prishtin
19. Yule, G. (2006) The Study of Language, Cambridge University Press.